



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.529/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Gentiana Krasniqi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Idajete Pira, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Viti, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Viti, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të largimit nga lista e kandidateve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, si kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Viti, në seancën e panelit të mbajtur me 27.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET i palejuar apeli Anr.529/2021 i datës 24.08.2021, i parashtruar nga Idajete Pira kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër KQZ-së, për shkak të largimit nga lista e kandidatëve për anëtarë të kuvendit komunal, për pjesëmarrjen në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 17 Tetor 2021.

A r s y e t i m

Parashtruesi i apelit Idajete Pira, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik PDK, me datën 24.08.2021 ka paraqitur një apel në PZAP, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin pretendon se KQZ-ja, e ka larguar nga lista e kandidateve për kuvendin Komunal, në mënyrë të padrejtë. E njëjta ka theksuar se lënda 2020:056109 e cila ka shërbyer për ta hequr nga lista ka të bëjë me gabim teknik gjatë mbushjes së formularit për deklarin e pasurisë e për të cilin është dënuar me gjobë nga Gjykata Themelore në Gjilan- dega në Viti, gjobë të cilën pretendon se e ka paguar me kohë dhe në sistemin e Gjykatave apo Policisë nuk figuron që ka ndonjë vepër penale për të cilën e cila do ta pengonte për të kandiduar për Këshilltare në Kuvendin Komunal të Vitisë. Andaj parashtruesja e apelit kërkon nga PZAP-i, që ta shqyrtojë ankesën dhe ta kthejë në listën e PDK-së për këshilltare komunale në Kuvendin Komunal të Vitisë.

Me datë 24.08.2021 PZAP, i ka paraqitur KQZ-së kërkesë për përgjigje duke kërkuar që të paraqesë përgjigje në ankesë deri me datë 25.08.2021 ora 12:00.

KQZ-ZRPPC-ja, në përgjigjen në ankesë ka theksuar, se ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), që të bëjë verifikimin e kandidatëve që marrin pjesë në garë zgjedhore për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 17 tetor 2021, nëse të njëjtit janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm nga Gjykatat e Republikës së Kosovës. Në këtë rast Idajete Pira, kandidate

për asamble komunale në Kuvendin Komunal në Viti nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nga të dhënat e pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në listën e Kandidatëve të subjektit politik PDK rezultojnë të jetë shpallur fajtor për vepër penale me vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përgjigjen e parashtruar ka sqaruar se subjekti politik PDK për kandidaten Idajete Pira ka dërguar zëvendësim më 24 gusht në ora 16:00, në zyrë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelimit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015-Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Paneli, konstaton se pretendimet ankimore të Idajete Pira, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik PDK, lidhur me largimin nga lista e kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 17 tetor 2021, nuk mund të jetë objekt i vlerësimit në këtë fazë të procesit zgjedhor, për faktin se, KQZ-ja ende nuk ka marrë vendim lidhur me certifikimin e listës së kandidatëve, ashtu siç del edhe nga vet përgjigja në ankesë e KQZ-së e parashtruar më datën 25.08.2021. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përgjigjen e parashtruar ka sqaruar se subjekti politik PDK për kandidaten Idajete Pira ka dërguar zëvendësim më 24 gusht në ora 16:00, në ZRPPC.

Kërkesa e ZRPPC-së, drejtuar subjekteve politike për zëvendësim të kandidateve të tyre nuk është vendim i KQZ-së, ndaj të cilit lejohet apeli, por është një kërkesë nga ZRPPC-ja, në lidhje me rastin në fjalë, ku subjektit është njoftuar se kandidati/ja në listën zgjedhore pas verifikimit nga ana e KGJK-së nuk është i përshtatshëm sipas Ligjit, dhe subjekti ka mundësi ta zëvendësoj me ndonjë kandidat tjetër brenda një periudhe të caktuar para se të rekomandohet nga zyreja në fjalë certifikimi/apo mos certifikimi i listës së plote të kandidateve. Pra faza kur është parashtruar apeli është e parakohshme sepse nuk kemi vendimmarrje të KQZ-se për certifikim të subjektit dhe listës së tyre, por kemi vetëm zëvendësim nga subjekti të cilit i përket apeli, dhe se subjekti nuk është i obligueshëm të beje zëvendësimin e kandidatit nëse vlerëson se të gjithë kandidatët janë të përshtatshëm konform nenit 29 të LZP-se.

Meqenëse në rastin konkret nga ana e KQZ-së nuk është marrë vendim lidhur me këtë çështje juridike, prandaj paneli vlerëson se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që në këtë fazë të procesit, të vendosë lidhur me largimin e kandidatëve nga lista, ngase sipas nenit 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht në dispozitën e sipërshtënuar. Në këtë rast, nga ana e KQZ-së nuk është marrë vendimi lidhur me certifikimin e listës së kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje apo largim të kandidatëve, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Hudhja e ankesës së ankuesit në këtë fazë të procedurës, mbi këtë bazë nuk cenon të drejtën e ankuesit që pas certifikimit të listës së kandidatëve për pjesëmarrjen në gara për Zgjedhjet

Lokale të cilat do të mbahen më 17 Tetor 2021, të paraqes sërish apel, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar, edhe pas certifikimit të listës nga ana e KQZ-së.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.529/2021 më datën 27.08.2021

Kryesues i Panelit

Faton Ademi



***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*